



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 717 prot.

Tiranë, më 18.06 2019

V E N D I M

Nr. 4, datë 12.06.2019

P Ë R

**MIRATIMIN PARAPRAK TË PËRBËRJES DHE FUNKSIONIMIT  
TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR ADMINISTRIMIN E UJËRAVE  
NDËRKUFITARE**

Në mbështetje të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 8, e të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, dhe të paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare, në vijim Komisioni, si më poshtë.
2. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për punët e jashtme dhe ka në përbërje këta anëtarë:
  - Zëvendësministrin përgjegjës për punët e brendshme;
  - Zëvendësministrin përgjegjës për mjedisin;

- Zëvendësministrin përgjegjës për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet;
  - Zëvendësministrin përgjegjës për energjinë;
  - Zëvendësministrin përgjegjës për ujitjen dhe kullimin;
  - Zëvendësministrin përgjegjës për mbrojtjen.
3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në rolin e sekretariatit teknik ka këto detyra:
- a) Organizon mbledhjet e Komisionit dhe njoftimin e anëtarëve;
  - b) Planifikon dhe harton projektaktet sipas tematikave përkatëse;
  - c) Realizon çdo detyrë tjetër që i ngarkon kryetari i Komisionit;
  - ç) Raporton periodikisht pranë Zëvendëskryeministrit për veprimtarinë e Komisionit.
4. Komisioni ngarkohet me administrimin e ujërave ndërkufitare, administrimin e marrëdhënieve me shtetet kufitare për këto ujëra, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.
5. Komisioni ka të drejtën të krijojë nënkomisione me ekspertë të fushave përkatëse për probleme dhe çështje specifike.
6. Veprimtaria e Komisionit mbështetet në legjislacionin shqiptar, si dhe protokollat, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.
7. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për ndjekjen e procedurës për emërimin e Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRACE**

